

AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

**PËRGJIGJET E KËRKESAVE TË TESTIT
(SKEMA E VLERËSIMIT)**

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja 5-vjeçare-seksioni dygjuhësh;

Shkolla e mesme me kohë të shkurtuar

Sesioni I, 9 qershor 2008

Varianti A

Kjo është një skemë qortimi, në të cilën jepen disa orientime lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të nxënësit.

- Testi përbëhet nga dy pjesë: një në poezi dhe një në prozë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 kërkesa.

Në vlerësimin e esesë duhet pasur parasysh:

- Përgjigja e nxënësit duhet vlerësuar në tërësinë e saj, për cilësinë që paraqet, për ndjeshmërinë, mendimin, idetë që ka shprehur dhe origjinalitetin e tyre.
- Nxënësit që kanë probleme në drejtshkrim, por arrijnë të komunikojnë me shkrim një të kuptuar të qartë të pjesës letrare (të tekstit të dhënë) dhe të kërkesës, do të marrin pikët e plota për të kuptuarit. Nga ana tjetër, nxënësit që shkruajnë qartë, rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk dëshmojnë ndonjë të kuptuar të mirë të tekstit dhe kërkesës, do të marrin pikë për mënyrën e shprehjes, stilin dhe saktësinë drejtshkrimore, por nuk do të vlerësohen për të kuptuarin. **Mos harroni**, se ky është një provim që vlerëson **aftësitë letrare** (përgjigjen letrare) dhe **jo aftësitë gjuhësore**.
- Gabime që nuk ndikojnë në cilësinë e përgjithshme të përgjigjes, nuk do të merren në konsideratë në vlerësim. Do të hiqen pikë vetëm për ato gabime që ndikojnë mbi cilësinë dhe që i gjykoni si të rënda.

PJESA I

Mjeda “Andrra e jetës”

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë

Pyetja 7 3 pikë

Model përgjigjeje

Përgjigjja i referohet në mënyrë të veçantë gjendjes **fizike** ose **shpirtërore** të Lokes.

- Lokja është vetmuar,
- E braktisur,
- E varfër,
- E mjerë,
- Pa njeri pranë.
- E plakur
- E pafuqi
- Në prag të vdekjes.

Ilustrimi me dy detaje:

- Me dy cokla në votër plaka,
- Rri gjithë natën e vajton,
- Të shuemen,
- Rri me duer kah ndezet flaka

1 pikë Nëse tregon gjendjen në të cilën ndodhet Lokja. (Nxënësi i referohet njërit prej varianteve të dhëna në modelin e përgjigjes.)

2 pikë Nëse gjen **dy** detaje nga fragmenti.

DHE

1 pikë Nëse gjen vetëm **një** detaj.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 8 2 pikë**Model përgjigjeje**

Figura e stilistikës: paralelizmi figurativ

Roli që luan:

- Krijon një përjasje midis natyrës dhe njeriut; OSE
- Krijon më shumë atmosferë, shërben si sfond (si një pikturë); OSE
- Natyra sikur paralajmëron për fundin e Lokes; OSE
- Dimër në natyrë dhe dimër në jetë; OSE
- E bën më të pranueshme vdekjen si proces i jetës; OSE
- Natyra është si e vdekur në dimër dhe po kështu jeta e Lokes është në përfundim të saj.

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës

1 pikë Nëse shpjegon rolin që ajo luan.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 9 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Ajo që Lokja sheh është një jetë e vetmuar, një jetë pa njeri pranë, pa gëzime, e varfër, pa një djalë, me një vajzë të martuar e një që s'jeton më. OSE
- Sheh një jetë që e ka humbur kuptimin e vet; OSE
- Sheh një grua të plakur; OSE
- Sheh një jetë me lodhje, të plakur, me shume dhimbje e pak gëzime.

Lokja e ndjen se është në momentet e fundit, jeta tashme e ka humbur kuptimin e saj për të, ndaj thërret morden (vdekjen).

1 pikë Nëse shpjegon se çfarë sheh Lokja në pasqyrën e jetës.

1 pikë Nëse tregon se si ky moment motivon veprimin që ajo bën më pas.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep shpjegime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 10 2 pikë**Model përgjigjeje**

Ritmi është i ngadalshëm, i qetë, i shtruar.

Arsyeja: Ky ritëm është në funksion të idesë së poetit:

- një jetë që po mbyllet në mjerim e trishtim; OSE
- jetë që po shkon ngadalë drejt fundit.

- 1 pikë** Nëse gjen ritmin e kësaj pjese.
1 pikë Nëse shpjegon arsyen e kësaj zgjedhjeje.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 5 pikë

Model përgjigjeje

Figurat e stilistikës: *personifikim ose prozopope* (në të dy strofat e fundit); *epiteti*: të shuemen, në trajtë *inversion*, të shpulpume; *krahasim*: porsì erë; *eufemizmi*: u ndal fryma e ajo mbaroi; *shkallëzimi i veprimeve*: u ndiej, vjen, u qas, uli, shtrëngoi, nguli, mbaroi.

Përfytyrimi i gjallë i vdekjes, me frymë që ecën është një mrekulli. Vdekja nuk lajmëron, e hap derën vetë. Vjen lehtë, tinëzare, befas, merr trajta njerëzore. Lexuesi ka mundësi ta përfytyrojë atë. Me anë të *epitetit*: të shuemen dhe *inversionit*: e n'grykë të shuemen e shtrëngoi, poeti thekson momentin kur vdekja shtrëngon plakën e mjerë. Përfytyrimi bëhet gjithnjë e më konkret e i frikshëm. *Epiteti*: të shpulpume rrit ngarkesën emocionale të vargut, ku përfytyrimin të vdekjes i shtohen edhe buzët e zhveshura, pa mish të saj. I gjithë ky proces i fundit i jepet përmes një shkallëzimi të veprimeve që vdekja kryen. Është interesant përdorimi i eufemizmit mbaroi në vargun e fundit, për të shmangur përdorimin e fjalës vdekje.

- 5 pikë** Nëse organizon interpretimin përmes **tri figurave** të stilistikës.
4 pikë Nëse e organizon interpretimin përmes **dy figurave** të stilistikës, por shprehet qartë dhe krijon përfytyrim të plotë.
3 pikë Nëse organizon interpretimin përmes **dy figurave**, por krijon një përfytyrim të pjesshëm.
2 pikë Nëse përmend **tri** figura bashkë me ilustrimet përkatëse, por nuk bën interpretim.
OSE **2 pikë** Nëse bën një interpretim të plotë dhe përmend vetëm **një figurë** bashkë me ilustrimin përkatës.
1 pikë Nëse përmend vetëm **një** figurë bashkë me ilustrimin përkatës.
OSE **1 pikë** nëse përmend vetëm **dy** figura bashkë me ilustrimet përkatëse.
OSE **1 pikë** nëse bën një interpretim të **pjesshëm**, por pa përmendur asnjë figurë stilistike.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjen fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, bën një koment që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12 1 pikë

- 1 pikë** Mjeda është realist, sepse pasqyron me vërtetësi gjendjen e varfër, të shkretët të Lokes.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjen fare.

Pyetja 13 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku të argumentojë pse Lokja është një figurë tragjike dhe çfarë e bën atë të tillë.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga teksti i dhënë
- përdor detaje mbështetëse
- ka qartësi mendimi

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë**

1 pikë **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 hyrjen
 zhvillimin
 përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si, koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- Përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike
- ka fjalor të pasur
- stil origjinal

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë** **(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm
- ka saktësi drejtshkrimore

PJESA II

Dostojevski “Krim e ndëshkim”

Pyetja 14	A	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	D	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë
Pyetja 20	B	1 pikë

Pyetja 21 3 pikë

Model përgjigjeje

Atmosfera është tragjike. Ka ankth, lemeri dhe tension.

Funksioni: Krijon një ndjenjë tmerri, padurimi për atë ç’mund të ndodhë nga momenti në moment.

1 pikë Nëse tregon se cila është atmosfera e këtij fragmenti.

1 pikë Nëse shpjegon funksionin artistik të saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 3 pikë

Momentet:

- Fillimisht ka frikë mos plaka nuk e pranon në shtëpi.
- Raskolnikovi ka frikë se mos e tradhton pamja;
- Atij s’i bindet zëri. Nuk arrin të flasë dot;
- Zëri i ngec në grykë, i dridhet;
- Raskolnikovi mezi e përmbajti veten;
- Mos pamja do ta tradhtonte;
- E pa me sy të shqyer;
- Duart i qenë dobësuar etj.

Ç’tregon kjo?

- Mungesa e përvojës tregon se ai nuk kishte kryer krim më parë;
- Raskolnikovi nuk ishte një vrasës i mirëfilltë;
- Raskolnikovi u detyrua të bëhej i tillë.

- 2 pikë** Nëse gjen dy momente. Nxënësi mund të perifranojë nga fragmenti ose të marrë ilustrime të gatshme.
- 1 pikë** Nëse shpjegon se ç'tregon kjo.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 4 pikë

Model përgjigjeje

Tipare gjuhësore të dialogut:

- Fjali të shkurtra;
- Fjali mungesore;
- Fjali pyetësor të njëpasnjëshme;
- Përdorimi i shpeshtë i reticencës.

Gjendja psikologjike e personazheve

- Ngarkesë emocionale; (Të dy)
- Tensioni i brendshëm; (Të dy)
- Dyshim nga e pathëna etj. (Të dy)
- Frikë; (Raskolnikovi)
- Pavendosmëri; (Raskolnikovi)
- Ankthin para krimit; (Raskolnikovi)
- Frikën që i krijon plakës dyshimi nga çdo i huaj.

- 2 pikë dhe 2 pikë dhe** Nëse gjen dy tipare gjuhësore të dialogut.
1 pikë nëse gjen vetëm një tipar gjuhësor të dialogut.
2 pikë dhe 1 pikë Nëse tregon gjendjet psikologjike të dy personazheve.
1 pikë nëse tregon gjendjen psikologjike vetëm të një personazhi.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 3 pikë

Model përgjigjeje

Krahasimi: Kishte dy sy si tehe brisku, si dy bishta miu

Epitetet: dyshimtarë, përgjues, flokët e verdhë, të thinjur, të lyer,

Efekt: Portreti i saj nuk të ngjall simpati, përkundrazi neveri, pështirosje.

- 2 pikë dhe 1 pikë** Nëse gjen **dy** figura bashkë me ilustrimet përkatëse.
1 pikë gjen vetëm **një** figurë bashkë me ilustrimet përkatëse.
- 1 pikë** Nëse tregon efektin që shkakton kjo mënyrë përshkrimi.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim, gjen figurën pa ilustrimin përkatës ose nuk përgjigjen fare.

Pyetja 25 **4 pikë****Model përgjigjeje**

Shprehjet frazeologjike: Do ia therte vrapit, zëri nuk iu bind, fuqitë iu prenë, të ka ikur fytyra, po i merreshin mendtë.

1 pikë Nëse gjen një shprehje frazeologjike, që shpreh tensionin psikologjik të Raskolnikovit.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjen fare.

Nxënësi nuk do të marrë pikë nëse gjen shprehje frazeologjike që s'kanë lidhje me gjendjen psikologjike të Raskolnikovit ose që nuk janë shprehje të tilla.